

IMAZHI I KOSOVËS NË ROMANIN “TRI KËNGË ZIE PËR KOSOVËN” TË ISMAIL KADARESË

L’IMAGE DU KOSOVO DANS LE ROMAN “TROIS CHANTS FUNEBRES POUR LE KOSOVO” D’ISMAIL KADARE

Isak SHEMA

Abstrakt

Objekt studimi i këtij punimi është trajtimi i temës së Kosovës në romanin e Ismail Kadaresë, me vështrim të veçantë për imazhin e Kosovës në romanin: “Tri këngë zie për Kosovë”. Imazhet e para për Kosovën i gjejmë në poezinë e viteve ‘60. Në poemën “Përse mendohen këto male?” etj. , poeti jep tablo të gjerë për fatin e popullit shqiptar gjatë shekujve. Në poezinë “Kosova” (1966) jep imazhin më të plotë për vendin gjatë fluturimit të parë me aeroplan mbi Kosovë. Poezia hapet me vargjet: “Sa herë kam kaluar mbi qiellin tënd, Kosovë,/ Midis reve të tua të rënda, gjëmimeve të tua”. Poezinë tjetër “Atje larg në Veri” (1968) ia kushton Gjakovës. Poezia “Mundja e ballkanasve nga turqit në Fushën e Kosovës më 1389”, e krijuar në vitin 1975, paraqet humbjen e ballkanasve në Luftën e Kosovës në shekullin XIV.

Duke u bazuar në këtë poezi, në Tiranë dhe në Paris, gjatë periudhës kohore mars 1997- mars 1998, në kohën e luftës çlirimtare të Kosovës, krijoi veprën “Tri këngë zie për Kosovën” dhe e botoi më 1998. Me tri tregime : Lufta e vjetër, Zonja e madhe dhe Lutje mbretërore, në sajë të mjeshtërisë artistike, në mënyrë parabolike paraqet të kaluarën dhe aktualitetin, luftën çlirimtare të shqiptarëve dhe atë pushtuese të Serbisë hegjemoniste. Dy rapsodët: shqiptari, Gjorg Shkreli dhe ai serb, Vlladani, këndojnë me lahutë këngët, me të cilat shprehin hasmërinë dhe rivalitetin më të hershëm midis shqiptarëve dhe serbëve. Gjorgu këndonte: “Ngrihuni shqiptarë, sllavët (serbët) po na marrin Kosovën, ndërsa Vlladani:”Çohuni ju serbë, shqiptarët po na e rrëmbejnë Kosovën”. Lahutarët nuk pranojnë të ndryshojnë këngët e tyre, dhe as të këndojnë një këngë të tretë. Megjithatë, me rastin e vdekjes së Zonjës së Madhe, këndojnë një variant të tretë të këngës së tyre, pa ndryshuar mesazhin e mëparshëm.

Në pjesën e tretë, Lutje mbretërore, bartës i rrëfimit është vetë mbreti i osmanëve, i vrarë gjatë Betejës së Kosovës dhe i varrosur “...nën tyrben dhe flakëzën e bishtikut ziplot”. Ai dëshmon për të kaluarën e tij tragjike, por edhe për vazhdimin e urrejtjes midis ballkanasve: “Serbë e shqiptarë këtë herë, duke tundur secili shenjë e vet: shqiptarët kryqin katolik, serbët atë ortodoks.” Informohet nga capa gazetash për luftën në Kosovë në vitin 1999, për “Emra vendesh, vezirësh befasues. NATO. R. Cook, Medeliene Albight. Ploja e fëmijëve në Drenicë. (un massacre d’ enfants a Drenica), Millosheviq, Mein Kampf... Herë-herë midis tyre është emri im: Murati I.” Edhe pas gjashtëqind vjetësh, i vetmuar, ai sheh se grindjet dhe luftërat e ballkanasve s’ kanë të ndalur. “Këngët i kishin po aq të egra sa edhe armët”. Me urrejtje të pa përmbajtur, mallkon dhe përsërit nëmën: “Mallkuar qofshi...Kokën hëngërshi, ballkanas të egër”.

Vepra “Tri këngë zie për Kosovën” ka zgjuar interesimin e madh të lexuesve dhe të kritikës letrare. Romani është përkthyer në disa gjuhë të botës. Në sajë të përkthimit të veprave letrare të tij në shumë gjuhë të botës, si edhe me tërë veprimtarinë e tërësishme si personalitet i rrallë i kulturës bashkëkohore shqiptare dhe evropiane, zë vend të merituar në historinë e letërsisë bashkëkohore.

Résumé

L’objet d’étude de ce travail est l’image du Kosovo dans le roman moderne d’Ismail Kadare: « Trois chants funèbres pour le Kosovo », Ismail Kadare (1936-2024) est un célèbre écrivain de la littérature albanaise de réputation mondiale. Le monde albanais, avec ses motifs, ses thèmes et sa présence sur le plan national et universel. On trouve les premières images sur le Kosovo dans la poésie des années 60. Dans le poème “A quoi pensent ces hautes montagnes?”, le poète donne un vaste tableau du destin du peuple albanais au cours des siècles. Dans la poésie “Kosova” (1966) il donne une image plus complète du pays lors de son premier vol en avion au-dessus du Kosovo.. Il consacre l’autre poésie “ Là-bas au loin dans le Nord” (1968) à la ville de Gjakovë.

La poésie “Défaite des Ballkaniques par les Turcs dans la plaine du Kosovo en 1389”(1975), présente la défaite des Balkaniques dans la Guerre du Kosovo au XIVème siècle. Se basant sur cette poésie, à Tirana et à Paris, durant la période mars 1997-mars 1998, à l’époque de la guerre de libération du Kosovo, il a créé l’oeuvre” Trois chants funèbres pour le Kosovo ».

Avec ses trois récits : La vieille Guerre, Une Grande Dame et Prière royale, il présente de manière parabolique le temps passé et le temps actuel, la guerre de libération des Albanais et celle de conquête de la Serbie hégémoniste. La longue Bataille du Kosovo s’est déroulée à Fushë Kosovë , entre d’un côté l’armée conquérante envahissante de l’Empire Ottoman, menée par le Sultan Murad, et de l’autre côté, l’armée commune des Balkaniques : Serbes, Bosniaques, Roumains et Albanais, commandée par le Prince Lazar. Après cette guerre sanglante, qui a duré dix heures, l’armée ottomane envahit ces régions balkaniques. Deux rhapsodes: l’un albanais, Gjorg Shkreli et l’autre serbe, Vlladani, chantent avec l’instrument lahouta les chants avec lesquels ils expriment l’inimitié et la rivalité la plus ancienne entre les Albanais et les Serbes. D’un côté Gjorg chantait : : “Dressez- vous Albanais, le Slave nous enlève le Kosovo” , et de l’autre Vlladan:” Levez-vous, Serbes, Les Albanais nous ravissent le Kosovo”. Les chanteurs s’accompagnant de la lahouta n’acceptent pas de modifier leurs chansons ni d’en chanter une troisième. Cependant, lors de la mort de la grande Dame, ils chantent une troisième variante de leur chanson, sans en modifier le message précédent .

Dans la troisième partie, Prière royale , le narrateur est le sultan même des Ottomans , tué lors de la Bataille du Kosovo.. Il témoigne de son tragique passé ainsi que de la continuité de la haine entre les Balkaniques :”Serbes et Albanais brandissaient leur emblèmes respectifs: les Albanais croix catholique; les Serbes la leur, orthodoxe”. Des morceaux de journaux l’informent sur la guerre du Kosovo en 1999 , des “ noms de lieu, de vizirs étonnants. OTAN. R. Cook, Madeleine Albright. Le massacre d’ enfants à Drenica), Milosević, Mein Kampf...” Parfois aussi, parmi eux, le mien, Murad I er.)

Même après 600 ans, esseulé, il voit que les disputes et les guerres balkaniques n’ont de cesse. “Leurs chants étaient aussi farouches que leurs armes”. Avec une haine contenue, il maudit et répète la malédiction: “Soyez maudits, peuples des Balkans... Puissiez-vous vous entredévorer, infidèles”.

Ismail Kadare est un célèbre écrivain de la littérature albanaise de réputation mondiale. Dans son oeuvre littéraire de grande valeur artistique, il présente une image du Kosovo. Sa contribution littéraire consacrée au Kosovo est très précieuse. Grace aux traductions de ses oeuvres en de nombreuses langues mondiales, ainsi que de toute son activité en tant que rare personnalité de la culture albanaise contemporaine, il prend une place méritée dans l’histoire de la littérature contemporaine.

Objekt studimi i këtij punimi është trajtimi i temës së Kosovës në romanin e Ismail Kadaresë “Tri këngë zie për Kosovën”

Bota shqiptare, si edhe universi, motivet dhe temat që lidhen me të, prania e saj në planin kombëtar dhe universal, paraqitet me dinjitet krijues dhe artistik në botimin e plotë përfundimtar të veprave të gjeniut të letërsisë shqipe dhe botërore të Ismail Kadaresë (26.07.1936-01.07.2024).

Tema e Luftës së Kosovës (1389) është trajtuar në shumë vepra letrare. Kësaj ngjarjeje historike i kushtohen këngë të ndryshme të epikës popullore. Në librin ‘Pyetje në albanologji’¹ Shaban Sinani shkruan për traditën gojore shqiptare dhe për motërzimet e këtyre këngëve historike. Po ashtu bën fjalë edhe për librin e Anna di Lellio Beteja e Kosovës 1989- një ep shqiptar”². Në bibliografinë e këtij punimi përfshihen edhe këngë të tjera epike historike kushtuar Betejës së Kosovës.

¹ Shaban Sinani, Pyetje në albanologji- autorë dhe teza, Tiranë 2013

² Anna di Lellio, Beteja e Kosovës 1989- një ep shqiptar”, Prishtinë, 2010



Edinburgh, 2006

Në epikën historike shqiptare, por edhe në gjuhë të tjera, shquhen shumë këngë kushtuar Luftës së Kosovës. Kadare është bazuar në këtë thesar letrar dhe në të ka gjetur mbështetje në procesin e krijimit të romanit të vet. Në letërsinë e shkruar shqipe kjo temë është e pranishme në disa poezi lirike, në poema, në krijime të prozës tregimtare dhe veçanërisht në romanin shqiptar. Në krijimtarinë letrare të Kadaresë është dhënë imazhi për Kosovë e të kaluarës, por edhe për atë bashkëkohore.

Imazhet e para për Kosovën i gjejmë në poezinë e viteve '60. Në poemën “Përse mendohen këto male?” etj. , poeti jep tablo të gjerë për fatin e popullit shqiptar gjatë shekujve. Në poezinë “Kosova” (1966) jep imazhin më të plotë për vendin gjatë fluturimit të parë me aeroplan mbi Kosovë. Poezia hapet me vargjet: “Sa herë kam kaluar mbi qiellin tënd, Kosovë, Midis reve të tua të rënda, gjëmimeve të tua”.

Poezinë tjetër “Atje larg në Veri” (1968) ia kushton Gjakovës. Poezia “Mundja e ballkanasve nga turqit në Fushën e Kosovës më 1389”³, e krijuar në vitin 1975, paraqet humbjen e ballkanasve në Luftën e Kosovës në shekullin XIV. Duke u bazuar në këtë poezi, në Tiranë dhe në Paris, gjatë periudhës kohore mars 1997- mars 1998, në kohën e luftës çlirimtare të Kosovës, krijoi veprën “Tri këngë zie për Kosovën” dhe e botoi më 1998.

³ Kadare, Vepra 7, Onufri, Tiranë, 2008, f. 271.



Me tri tregime : *Lufta e vjetër, Zonja e madhe dhe Lutje mbretërore*, në sajë të mjeshtërisë artistike, në mënyrë parabolike paraqet të kaluarën dhe aktualitetin, luftën çlirimtare të shqiptarëve dhe atë pushtuese të Serbisë hegjemoniste. Beteja e Kosovës, e zhvilluar gjatë më 28 qershor 1389 në Fushën e Kosovës midis ushtrisë pushtuese të Perandorisë Otomane, të udhëhequr nga Sulltan Murati, në njërin anë, dhe ushtrisë së përbashkët të ballkanasve: të serbëve, të boshnjakëve, të rumunëve dhe të shqiptarëve, të komanduar nga Princ Llazari, në anën tjetër. Pas luftës së përgjakshme, që zgjat dhjetë orë, ushtria osmane pushtoi viset ballkanike, për t'i mbajtur nën sundimin e vet pesë shekuj me radhë.

Dy rapsodët: shqiptari, Gjorg Shkreli dhe ai serb, Vlladani, këndojnë me lahutë këngët, me të cilat shprehin hasmërinë dhe rivalitetin më të hershëm midis shqiptarëve dhe serbëve. Gjorgu këndonte: “Ngrihuni shqiptarë, sllavët (serbët) po na marrin Kosovën, ndërsa Vlladani:” Çohuni ju serbë, shqiptarët po na e rrëmbejnë Kosovën”. Lahutarët nuk pranojnë të ndryshojnë këngët e tyre, dhe as të këndojnë një këngë të tretë. Megjithatë, me rastin e vdekjes së Zonjës së Madhe, këndojnë një variant të tretë të këngës së tyre, pa ndryshuar mesazhin e mëparshëm. Ata “...si të mpirë kënduan këngën për të: Ra mjegull e zezë, vdiq Zonjë e madhe...ngrehuni serbë se Kosovën e mori shqiptari. Seç ra mjegull e zezë, vdiq Zonjë e madhe, ngrehuni shqiptarë se në Kosovë ra shkau.

Në pjesën e tretë, *Lutje mbretërore*, bartës i rrëfimit është vetë sulltani i osmanëve, i vrarë gjatë Betejës së Kosovës dhe i varrosur “...nën tyrben dhe flakëzën e bishtikut ziplot”. Ai dëshmon për të kaluarën e tij tragjike, por edhe për vazhdimin e urrejtjes midis ballkanasve: “Serbë e shqiptarë këtë herë, duke tundur secili shenjën e vet: shqiptarët kryqin katolik, serbët atë ortodoks.” Informohet nga capa gazetash për luftën në Kosovë në vitin 1999, për “Emra vendesh, vezirësh befasues. NATO. R. Cook, Medeliene Albight. Ploja e fëmijëve në Drenicë. (un massacre d` enfants a Drenica), Millosheviq, Mein Kampf... Herë-herë midis tyre është emri im: Murati I.” Edhe pas gjashtëqind vjetësh, i vetmuar, ai sheh se grindjet dhe luftërat e ballkanasve s`kanë të ndalur. “Këngët i kishin po aq të egra sa edhe armët”. Me urrejtje të pa përmbajtur, mallkon dhe përsërit nëmën: “Mallkuar qofshi...Kokën hëngërshi, ballkanas të egër”. Vepra “Tri këngë zie për Kosovën” ka zgjuar interesimin e madh të lexuesve dhe të kritikës letrare. Romani është përkthyer në disa gjuhë të botës. Eric Faye në parathënien e botimit në gjuhën frënge prozën e Kadaresë e vlerëson lart dhe në aspektin kohor e lidh me ngjarjet e viteve `90 të shekullit të kaluar, pra me vitin 1989, kur merr hov lufta për çlirimin e Kosovës. Ai shkruan: “... libri përfshin alfën dhe omegën, pra dy pikat e skajshme të luftës së përgjakshme në tokën e Kosovës. Toni i këtij libri është i përkundërt me nacionalizmin. Asgjë

nuk i shtyn serbët e shqiptarët të jenë kundër njëri tjetrit, përveçse gjurmët që urrejtja ka depozituar në kujtesën kolektive”⁴

Literi: Rrëfimi i Albanologjisë dhe
të fjalës shqipe e më tej shprehja në shkrim
shprehja që më shprehja e saj dhe më të
Ky literi: Rrëfimi dhe të fjalës shqipe
ndërkohë që shprehja e shprehja shprehja
shprehja e shprehja e shprehja shprehja, për
të cilin më shprehja dhe shprehja shprehja,
shprehja e shprehja.
Ky literi dhe të shprehja shprehja shprehja.
shprehja shprehja shprehja, shprehja shprehja,
shprehja e shprehja, shprehja e shprehja,
shprehja e shprehja, shprehja shprehja e shprehja
shprehja. Ky literi dhe të shprehja shprehja
shprehja e shprehja të shprehja shprehja.


Ismail Kadare
19 Oktobra 1998
TIRANË

Dorëshkrim i Ismail Kadaresë

Në një intervistë, në pyetjen lidhur me përkrahjen e Kosovës dhe të popullit të saj gjatë njëzet viteve të fundit, Kadare përgjigjet: "...Unë mbrojta lirinë e popullit kosovar, gjë që do ta bëja për të gjithë popujt e tjerë. Nuk ishte diçka speciale, fakti që unë jam shqiptar. Ajo ishte një kauzë e qartë, ishte një skandal që në Evropë një popull të jetonte ende në kushte koloniale. Reputacioni im si shkrimtar mund të ishte dëmtuar për këtë, pasi nuk është e lehtë për një shkrimtar të vazhdojë të mbështesë idenë se Jugosllavia duhet të ndëshkohet për shtypjen e tmerrshme që kishte kryer në Kosovë. Nuk është e lehtë për një shkrimtar, pasi sipas klisheve, shkrimtarët duhet të jenë kundër çdo lloj ndëshkimi, mbi të gjitha, bombardimeve.”⁵ Megjithatë, Kadare lidhur me rrëfimin e tij romansor në këtë vepër shpreh: “Rrëfimi im vjen nga ajo që unë e quaj “objektivitet homerik”.... jam munduar ta respektoj këtë ligj: të jem në krijimtarinë time letrare neutral E gjithë kjo më ka dhënë një ekuilibër në atë vënd të vështirë. Gjë, tepër e vështirë”.

⁴ Ismail Kadare, Vepra, Vëllimi i nëntë, Fayard, Paris, 2000, f. 377.

⁵ www.kavajaonline.com/forumi/topic/257-ismail-kadare-bibliografia. (Më 1 qershor 2014)



Në parthënien e romanit Eric Fay shkruan: “ Ismail kadare e kujton këtë betejë në veprën e tij shumë më përpara se viti vendimtar 1989, duke marrë atje një traditë të epopesë gojore dhe asaj të shkruar shqiptare. Kështu ajo del më 1975 në formën e një poeme të shkurtër : « Humbje ballkanasve prej turqve në Fushën e Kosovës » si dhe, më pas, në shumë tekste të tjerë të tij. Por është viti 1997 që, duke rimarrë tonin epik të « « kasneceve të shiut » Ismail Kadare « rishikon » psikozën para betejës si dhe zhvillimin e saj, duke na dhënë këtë me « Luftën e vjetër », që është pjesa e parë e librit « Tri këngë zie për Kosovën »...Atje shohim rapsodë serbë e shqiptarë, që bëjnë lajmëtarin e rivalitetit serbo-shqiptar në Kosovë, që i ka rrënjët shumë përpara se të fillonin luftimet kundër trupave otomane ».⁶

Romani i Ismail Kadaresë me shpejtësi të madhe është përkthyer në shumë gjuhë të botës. Zëri i këtij autori, duke folur për Kosovën, është dëgjuar me interesim të jashtë jashtëzakonshëm. Julien Gracq, personalitet i shquar i kulturës moderne frenge, shkruan : « Janë të paktë librat bashkëkohorë që më kanë tronditur sa *Tri këngë zie për Kosovën* që Ismail Kadareja e botoi në vitin 1998, pikërisht në kohën kur një krizë me përmasa ndërkombëtare po ngjizej sërish përreth *Fushës së mëllenjave*... ».

Për *riendjen e mitit* në letërsinë e kadaresë, shkruan Stephen Brown (*Observer*, shkurt 2000). “...Kadare shkruan një prozë lirike të dendur, të gjallëruar nga një zgjuarsia dinake, që here pas here shoqërohet me me metafora jonxitëse ogurzeza. Këto tregime kërkojnë një truall në historinë e Ballkanit dhe në Evropën Mesjetare. Ato janë pjesërisht rishikim historic dhe, pjesërisht fabul. Kadareja e rindërton të kaluarën në një përzjerje rrëmuje dhe pëshpëritjesh, por gjithashtu dëshiron që ta riendë në një lloj të ndryshëmmiti- një tragjedi të Evropës. Kosova bashkon Lindjen e Evropës me verbërinë drejt Lindjes dhe i jep rajonit një fatalitet, që është në të njëjtën kohë mallkim dhe bekim”.

Kritiku letrar, John Murray, duke i paraqitur të tri fabulat si një tërësi kompozicionale të romanit, shprehet se “...Kadareja lëviz në drejtim të kundërt me paranojë shoviniste. Në vend të kësaj, ai i shikon të gjithë protagonistët, duke përfshirë këtu edhe turqit, nga një perspektivë tolerante”.

⁶ Ismail Kadare, *Vepra*, Vëllimi i nëntë, Fayard, Paris, 2000, f. 376.

Një bard merret me Kosovën. Julian Evans shpreh mendimin vlerësues se vepra *Tri këngë zie për Kosovën* «...është humane, lirike, komike, e drejtpërdrejtë dhe emocionuese. Pika zotëruese në shkrimin e këtyre tri fabulave, si edhe në veprat e tjera të tij, është se ai dërgon mesazhe për lirinë, kryesisht për të shkruar të vërtetën, jo domosdoshmërisht me fakte, por të vërtetën njerëzore. Në këtë libër të shkurtër, objektiv, por megjithatë fisnik, Kadareja e ka vendosur Kosovën- betejën, mitin- të çliruar nga zinxhirët e pavërtetësisë “.

Jorgo Bullo, njëri ndër studiuesit e shquar të letërsisë shqiptare të traditës dhe të kësaj bashkëkohore, shquan rolin e jashtëzakonshëm të shkrimtarit për zhvillimin e letërsisë së sotme shqipe. “Vepra e Kadaresë – shkruan ai, është shprehje e pasurimit të kulturës universale me traditat kombëtare artistike të popujve të vegjël me qytetërim të lashtë, siç është populli shqiptar, një nga më të vjetrit në Ballkan. Nga një lidhje e fortë me këtë truall, që vjen nga lashtësia e gadishullit dhe e gjallërimit të mitologjisë së tij antike, vepra e Kadaresë i sjell letërsisë evropiane një aromë karakteristike mesdhetare dhe e pasuron atë me koloritin e një areali tipik për veçansinë e tij etnokulturore. Filozofia, mendësia dhe traditat historike e kulturore të shqiptarëve, janë paraqitur në veprën e Kadaresë si shprehje e identitetit të fortë kombëtar, e vitalitetit të kulturës shpirtërore të popullit të vet dhe si faktor i qëndrësë dhe i mbijetesës së tij. Krijues me vetëdije të lartë kritike, Kadareja jo vetëm ka poetizuar vlerat shpirtërore të kombit të vet, por edhe ka fishkulluar traditat anakronike, mentalitete retrograde, psikologjinë provinciale dhe konvencionet e jetës së shoqërisë shqiptare .»⁷

“Vlerat e veprës së tij janë të begatshme dhe të shumëllojshme, sikurse është vetë ajo e begatshme dhe e shumëllojshme. Në tërësinë e letërsisë shqipe, dhe, në kuptimin e mirëfilltë letrar, ajo është më e pasura, më e madhja dhe më e rëndësishmja. Risuese në poezi, në prozë, veçanërisht në roman, dhe, shpesh mbi nivelin e përgjithshëm të saj, ajo e ka ngritur letërsinë shqipe në shkallaret më të larta, herë-herë të njëjta me letërsitë e tjera evropiane dhe botërore”.

8

Imazhi unik i Kosovës është në romanet e Ismail Kadaresë , është ai i krijuesit humanist. Vepra e tij përfshin shumë aspekte të qytetërimit shqiptar dhe të atij botëror. Mesazhi i tij në letërsi është paqedashës dhe i kushtohet lirisë së popullit shqiptar, por edhe të mbarë njerëzimit. Ismail Kadare në prozën e tij moderne në mënyrë të mrekullueshme spikat imazhin dhe mesazhin artistik për Kosovën. Në mesazh i tillë paraqitet edhe në veprën artistike figurative “Paqe në Kosovë” të piktorit të famshëm, Ibrahim Kodra. Ismail Kadare është shkrimtar i shquar i letërsisë shqiptare me famë botërore. Me opusin letrar, që ka vlerë të lartë artistike, paraqet edhe imazhin e Kosovës. Kontributi i tij letrar kushtuar Kosovës është i shumë i çmuar.

Në saje të përkthimit të veprave letrare të tij në shumë gjuhë të botës, si edhe me tërë veprimtarinë e tërësishme si personalitet i rrallë i kulturës bashkëkohore shqiptare dhe evropiane, zë vend të merituar në historinë e letërsisë bashkëkohore. Për veprimtarinë letrare me vlerë të lartë artistike dhe për merita të jashtëzakonshme që ka dhënë ai në fushën e letërsisë, ka fituar shumë mirënjohje dhe shpërblime letrare. Ai shumë vjet me radhë ishte kandidat serioz, i merituar, për të fituar Çmimin Nobel për Letërsi.

⁷ Bullo, Jorgo, *Ardhja e Kadaresë në letërsinë shqipe*, “Magjia e fjalës”, Dituria , Tiranë, 1998, f. 179.

⁸ Intervista/ Flet Prof. Dr. Bashkim Kuçuku . www.merbraha.com/index.php/intervista/1819.html, 2009-07-03 17:31 +0100 , është cituar më 20 tetor 2013

Referencat

- [1]. Kadaré, Ismail :Tri këngë zie për Kosovën. (1998) , triptik. Onufri,
- [2]. Tri këngë zie për Kosovën .(1999), triptik, Onufri,Tiranë.
- [3]. Tri këngë zie për Kosovën .(2000), triptik, Vepra, Vëllimi i nëntë. “Fayard”, Paris.
- [4]. Krushqit janë të ngrirë , në Koha e shkrimeve. (1986), Tiranë.
- [5]. Baladë për vrasjen e J.G.: në Koha e shkrimeve. (1986). Tiranë.
- [6]. Krushqit janë të ngrirë. (2000), roman. Vepra,Vëllimi i nëntë.”Fayard”, Paris.
- [7]. Kadaré, Ismail. (2008). Vepra 7. Onufri. Tiranë.
- [8]. Kadaré, Ismail. (2000). Balade sur la mort de J.G., Œuvres, tome neuvième. Fayard, Paris.
- [9]. Three Elegies for Kosovo. (1998). “The Harvill Press”, London.
- [10]. Elegy for Kosovo.(2000). “Arcade Publishing”, New York.
- [11]. Trois chants funebres pou le Kosovo. (1998).”Fayard”, Paris.
- [12]. Trois chants funebres por le Kosovo. (2000). Ouvres, Tome neuvieme.”Fayard”, Paris.
- [13]. Die rowzangen vdor Kossovo.(1999).,”Van Gennepe”, Amsterdam.
- [14]. Tre canti funebri per il Kossovo. (1999). “Longanesi &C”, Milano.
- [15]. Tre canti funebri per il Kossovo. (2003). “Longanesi &C”, Milano.
- [16]. Tre cants funebres per Kosovo. (1999).”Proa”, Barcelona.
- [17]. Tres cantos funebres pelo Kosovo. (1999). “Dom Quixote”, Lisboa.
- [18]. Tres cantos funebres para o Kosovo (1999). ” Editora Objetiva”, Rio de Janeiro.
- [19]. Tres cantos funebres por Kosovo.(1999). ”Alianza Editorial”, Madrid.
- [20]. Tres cantos funebres por Kosovo. (2004).”Alianza Editorial”, Madrid.
- [21]. Kosovo ya uç agit. (1999). “Gunesli”, Istanbul.
- [22]. Tre seresanger for Kosovo. (1999). (Norwegian).
- [23]. Tria tragudhja penthima ja to Kosifopegjo. (2000). “Ekdhosis tu ikostu protu”, Athina.
- [24]. Tri elegjie za Kosovo. (2000). “Edicija Bozicevic”, Zagreb.
- [25]. *Le cortège de la noce s'est figé dans la glace. (1984). Fayard, Paris.*
- [26]. L` Anné noire suivi de Le cortege de la noce s'est fige dans la glace. (1987). “Fayard”, L` Anné noire suivi de Le cortege de la noce s'est fige dans la glace .(1992). “Fayard”, Paris.
- [27]. L` Anné noire suivi de Le cortege de la noce s'est fige dans la glace. (1992). “Fayard”, Paris/ Livre de Poche.
- [28]. L` Anné noire suivi de Le cortege de la noce s'est fige dans la glace. (1992). “Fayard”, L` Anné noire.(1991). (Viti i mbrapsht), Le cortege de la noce s'est fige dans la glace (Krushqit janë të ngrirë),(Titujt janë në hebraisht dhe në frëngjisht) Printed in Israel, “E. Lewin- Epstein”.
- [29]. De verssteende bruidstoet. (2000). (Krushqit janë të ngrirë). “Van Gennepe”, Amsterdam.
- [30]. Kadare, Ismail. Œuvres , 12 tomes. Fayard, Paris, 1993 – 2004.
- [31]. Kadare, Ismail, Vepra, 12 vëllime. Fayard, Paris, 1993- 2004. Kadare, Ismail. Vepra e plotë, I-XX vëllime, Botime të SHB Onufri, Tiranë, 2007-2009. Vëllimi I:“Qyteti pa reklama”, “Ditë kafenesh”, “Përbindëshi”.Vëllimi II: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Njëmbëdhjetë tregime”.
- [32]. Vëllimi III: “Rrethimi”.
- [33]. Vëllimi IV: “Kronikë në gur”, “Lëkura e daulles”.
- [34]. Vëllimi V: “Dimri i vetmisë së madhe”.
- [35]. Vëllimi VI: “Koncert në fund të stinës”.
- [36]. Vëllimi VII: “Poezi dhe poema”.
- [37]. Vëllimi VIII: “Muzgu i perëndive të stepës”, “Kamarja e turpit”, “Komisioni i festës”.
- [38]. Vëllimi IX: “Nëntori i një kryeqyteti”, “Tregime dhe novela”.
- [39]. Vëllimi X: “Ura me tri harqe”, “Kush e solli Doruntinën”, “Breznitë e Hankonatëve”.
- [40]. Vëllimi XI: “Prilli i thyer”, “Pallati i ëndrrave”.
- [41]. Vëllimi XII: “Dosja H”, “Krushqit janë të ngrirë”, “Qorrfermani”, “Viti i mbrapshtë”.
- [42]. Vëllimi XIII: “Hija”, “Nata me hënë”, “Vajza e Agamemnonit”, “Pasardhësi”.
- [43]. Vëllimi XIV: “Piramida”, “Rrëfim trikohësh”, “Shtatë novela”.
- [44]. Vëllimi XV: “Spiritus”, “Lule të ftohta të marsit”, “Tri këngë zie për Kosovën”.
- [45]. Vëllimi XVI: “Shkaba”, “Çështje të marrëzisë”, “Aktori”, “Stinë e mërzitshme në Olymp”.
- [46]. Vëllimi XVII: “Aksidenti”, “Darka e gabuar”, “E penguar”.
- [47]. Vëllimi XVIII: “Ftesë në studio”, “Eskili, ky humbës i madh”, “Dantja i pashmangshëm”. “Hamleti, princi i vështirë”, “Don Kishoti në Ballkan”.
- [48]. Vëllimi XIX: “Legjenda e legjendave”. “Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe”, “Kushëriri i engjëjve. “Legjenda e legjendave”. “Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe”, “Kushëriri i engjëjve”, “Arti si mëkat”, “Ra ky mort. dhe u pamë”, “Dialog me Alain Bosquet”.

- [49]. Vëllimi XX: “Nga një dhjetor në tjetrin”, “Pesha e kryqit”, “Bisedë në “Hylli i dritës”, “E vërteta që del nga qilarët”, “Identiteti evropian i shqiptarëve”, “Sorkadhet e trembura”. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Fjalor enciklopedik shqiptar*. (2008). Vëllimi i dytë, Tiranë.
- [50]. Aliu, Ali. (1999). “Kërkime”. Naim Frashëri, Tiranë.
- [51]. Aliu, Gëzim. (2007). *Diskurset e ideve në prozën e Ismail kadaresë*. “Faik Konica”, Prishtinë
- Bellos, David. *The englishing of Ismail Kadaré*, Complete review Quarterly, Volume VI, Issue 2, May, 2005.
- [52]. Beqiri, Shaip.(1991). *Sfida e gjeniut*. Prishtinë.
- [53]. Bosquet, Alain. (1995). *Dialogue avec Alain Bosquet*. Fayard, Paris.
- Bulo, Jorgo.(2006). *Kadaré et les lettres albanaises*. Studime filologjike, Tiranë. (1-2/2006), pp 5-9.
- [54]. Corti, José. (1991). *Entretiens avec Ismail Kadaré*. Paris.
- [55]. Çapriqi, Basri.(2006).*Paradigma Kadare*. Onufri, Tiranë.
- [56]. Çausi, Tefik. (1993). *Universi letrar i Kadaresë*. Onufri, Tiranë.
- [57]. Çausi, Tefik. (1995). *Kadare- Fjalor i personazheve*. SHBE, Tiranë.
- [58]. Çausi, Tefik. (2002). *Kadareja përmes pasqyrave*. Onufri, Tiranë
- Çausi, T- Shkurtaç, GJ. (2002).
- [59]. *Kadareja dhe gjuha shqipe*. Onufri, Tiranë.
- [60]. Dabitch, Christophe. Extrait d'un article, *Le Matricule des anges*, 1999. www.bibliomonde.com/.../trois-chants-funebres-pour le Kosovo Di Lellio, Anna. (2010). *Beteja e Kosovës 1989- një ep shqiptar*. Prishtinë.
- [61]. Evans, Julian.1999. *Beteja e Kosovës e shekullit XIV*. Weekend Post Books. In Kuçuku, Bashkim.(2005).*Kadare në gjuhët e botës*. Onufri. Eissen, Ariane & Gély, Véronique (dir.).(2013). *Lectures d'Ismail Kadaré*.Presses Universitaires de Paris, Paris.
- Faye, Eric. (2000).*Trois Chants funebres pour le Kosova*. In Ismail Kadaré. Oeuvres, tome neuvieme. Fayard, Paris.
- [62]. Faye, Eric. (1991). *Ismail Kadaré, Prométhée porte-feu*. José Corti, Paris.
- Filipi, Yllka.(2012). *Dante Migjeni, Kadare, Trekëndëshi internal universal*. Albas, Tiranë.
- Gilles de Rapper et Ismail Kadaré.(2004). *L'Albanie entre la légende et l'histoire*, Actes Sud.
- Kadare, Ismail. (1998). *Tri këngë zie për Kosovën, tregime*.”Onufri,
- [63]. Kadare, Ismail. (2000). *Tri këngë zie për Kosovën, tregime*, Vepra, Vëllimi i nëntë, « Fayard », Paris.
- [64]. Kadare, Ismail. (2008). Vepra 7. Onufri. Tiranë.
- [65]. Kadaré, Ismail. (2000). *Ballade sur la mort de J.G*. Oeuvres, tome neuvieme, Fayard, Paris pp 627-645.
- [66]. Kadaré, Ismail.(1991). *Entretiens avec Eric Faye*, José Corti, Paris.
- Kadaré, Ismail. (1999).*Temps barbares*, entretiens avec D. Fernandez-Récatola. Archipel, Paris.
- [67]. *Kadaré, Ismail. (1993). Gardien de mémoire*, colloque. Association des écrivains de langue française, SEPEG International, Paris.
- [68]. Kabashi, Emin. (1998). *Kadare-mendësia shqiptare* , Prishtinë.
- [69]. Kraja, Mehmet.(2009). *Kadareja dhe Kosova*. Ismail Kadare.Vepra 12, Onufri. Tiranë.
- [70]. Krasniqi, Bajram. (1978). *Poetika e prozës së Ismail Kadaresë*, Tezë e magjistraturës .IAP, Prishtinë.
- [71]. Kuçuku, Bashkim. *Ja përmasa e plotë dhe relievi i njëmendtë i letërsisë shqipe*, Interview, Kuçuku, Bashkim. (2005). *Kadare në gjuhët e botës*. Onufri, Tiranë.
- [72]. *Les Belles Etrangères*, (1998). 13 écrivains d'Albanie, Ministère de la culture et de la communication.CNL.
- [73]. M'raih, Mariam. (2004). *Ismail Kadaré ou l'inspiratin prometheenne*. Paris, L'Harmattan.
- [74]. Métais, Michel. (1973). *Ismail Kadaré et la nouvelle poésie albanaise* Édition Pierre Jean Oswald, *Qosja, Rexhep*.(1983). *Nocione te reja albanologjike*. IAP, Prishtinë.
- [75]. Revue *L'Œil de bæuf*, numéro spécial sur Ismail Kadaré, Paris, 2000.
- [76]. Rustemi, Fatbardha. (2001). *Them se e njoh Kadarenë*, Tiranë.
- [77]. Sinani, Shaban.(2013). *Pyetje në albanologji- autorë dhe teza*, “Naimi”, Tiranë.
- Sinani, Shaban. (1997). *Pengu i moskuptimit*, Tiranë.
- [78]. Sinani, Shaban. (2005).*Një dosje për Kadarenë I*, » Omska », Tiranë.
- [79]. Sinani, Shaban. (2005).*Një dosje për Kadarenë II*. Tetovë.
- [80]. Sinani, Shaban, « Krushqit janë të ngrirë » në gjykimin e kohës, në Konferencën shkencore ndërkombëtare « Letërsia shqipe dhe Kosova », gusht 2008, Prishtinë.
- Sinani, Shaban. (2009). *Për prozën e Ismail Kadaresë*, « Naimi » Tiranë.
- [81]. Shaip,Shaip.(1991). *Sfida e gjeniut*. Prishtinë.

- [82]. Shema, Isak. (2006). Ismail Kadare fitues i Çmimit Ndërkombëtar *Njeriu i Librit 2005*. Onufri, Tiranë.
- [83]. Shema, Isak. (2008), *Studime letrare*. AAB, Prishtinë.
- [84]. Uçi, Alfred. (2000). *Grotesku Kadarean*. Onufri, Tiranë.
- [85]. Velo, Maks. (2002). *Zhdukja e pashallarëve të kuq*.
- [86]. Velo, Maks. (2004). *La disparition des "Pachas rouges" d'Ismail Kadaré, enquête sur un crime littéraire*. Fayard, Paris.
- [87]. Zamputi, Injac. (1993). *Ekskursion në dy vepra të Kadaresë. Dituria*, Tiranë.
- [88]. Zotos, Alexandre. (1997). *De Scanderbeg à Ismail Kadaré*. Publication de l'Université de Saint-Étienne, Paris.